



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 103 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 12 / 08 / 2025

VENDIM

Nr. 24 datë 12 / 08 / 2025

PËR

MBIKQYRJEN DHE PUNIMET PER RIKONSTRUKSIONIN E DIGES SE MANSKURISE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 12.08.2025 mori në shqyrtim situatën në lidhje me procesin e punimeve dhe mbikqyrjes së tyre për rikonstruksionin e diges së Manskurisë si dhe plotësimin e kërkesave të KKDM të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 15, datë 14.05.2025. Gjatë kësaj kohe, AKUK ka nxjerr lejen e ndërtimit për kryerjen e punimeve si dhe ka dorëzuar dokumentat në lidhje me mbikqyrjen e punimeve për rikonstruksionin e kësaj dige.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj firmën konsulente ZENITH shpk të përcaktuar nga AKUK si Mbikqyrëse e Punimeve për rikonstruksionin e digës së Manskurisë.
- 2- Ti kërkoj Agjencisë Kombëtare të Ujesjellës - Kanalizimeve (AKUK) dorëzimin e dokumentacionit të plote të Projektit të zbatimit duke përfshirë edhe plotësimet përkatëse të kërkuara nga KKDM sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- 3- Ti kërkoj Agjencisë Kombëtare të Ujesjellës - Kanalizimeve (AKUK) krijimin e kushteve për kontrollin e punimeve nga ITD dhe përfaqësuesi i KKDM sipas kërkesave të nenit 21 dhe 22 të VKM se mesiperme. Njëkohësisht, Investitori duhet të krijoj kushtet e duhura për kontrollin e punimeve nga ITD sipas kërkesave të nenit 21 të VKM se mesiperme.
- 4- Rimbushja e ujëmbledhësit të Manskurisë pas përfundimit të punimeve dhe Kolaudimi i punimeve duhet të kryhet duke respektuar kërkesat e Nenit 24 dhe 25 të VKM se mesiperme. Akti i Kolaudimit të punimeve duhet të miratohet në KKDM.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM dhe ITD për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

